



Datë: 07.03.2025
Numër Protokolli: 1525/2025

A.nr.208/2025

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Ylber Fetahaj, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.208/2025, të datës, 24.01.2025, të parashtruar nga ankuesja SH.SH, kundër organit të punësimit: Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 07.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I.** Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.208/2025, e datës 24.01.2025, e parashtruar nga ankuesja SH.SH.
- II.** Obligohet Sekretarja e Përgjithshme dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme, që brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi, të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme administrative, në mënyrë që ankueses t’ i bëjë kompensimin e diferencës së pagës sipas listës së miratuar për ekspertë dhe atë në mënyrë retroaktive nga muaji shkurt 2023 deri në muajin gusht 2024.
- III.** Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja SH.SH(tani e tutje referuar si ankuesja), më datë 24.01.2025, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të mos kompensimit të diferencës së pagës lidhur me pozitën e ekspertit dhe atë për periudhën shkurt 2023 deri më datë 13.08.2024.

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 11.02.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Punëve të brendshme, ndërsa, kjo e

fundit, me datë 25.02.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me provat materiale lidhur me këtë çështje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 530/2025 të datës 24.01.2025 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e ID së ankuses; Vendimin me Nr. 23/165 të datës 12.10.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendimin me Nr. 09/216 të datës 14.08.2024 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Kërkesën për kompensim retroaktiv të datës 22.11.2024; Dëshmi nga sistemi i pagave nga Thesari i Kosovës për ankuesen për muajin shtator, tetor, nëntor, dhjetor 2024; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 31.01.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 25.02.2025; Akt Emërimit të datës 03.10.2016; Listën e pagave për ankuesen nga muaji gusht deri në muajin dhjetor 2024 dhe listën e pagave të muajit janar 2025.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesja është e bazuar, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se ankuesja sipas Akt Emërimit të datës 03.10.2016, mban pozitën e punës Zyrtar e TI-së për Përkrahej, në kuadër të Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit, tani Ministrinë së Punëve të Brendshme.

Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin Nr.07/132 të datës 08.03.2023 ka themeluar Komisionin për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike, përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave të dërguara nga institucionet që kanë të bëjnë me sistemin shtetëror të informacionit dhe komunikimit më rëndësi strategjike sipas Rregullores Nr.11/2023 për Ekspertët dhe dërgimin në Qeveri, të listës së Eksperteve, të kategorizuar në shtojcën 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik. Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike, ka përgatit Raportin e punës, listën e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimeve me rëndësi strategjike dhe listën e pozitive të eksperteve sipas shtojcës 14.4 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, të cilat janë miratuar nga Qeveria e Kosovës, me Vendimin Nr.23/165 të datës 12.10.2023. Rrjedhimisht sipas listës së miratuar, për Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit janë pranuar si sisteme strategjike: Sistemet e informacionit për siguri Kibernetike qeveritare; Sistemet e Informacionit në qendrën shtetërore e të dhënave; Platforma eKosova; Platforma e Interoperabilitetit-GG; Sistemi i telefonisë dhe rrjetit kompjuterik shtetëror; Infrastruktura për hosting të aplikacioneve dhe data bazave përkatëse të IRK-ve në platformën Microsoft; Infrastruktura për hosting të aplikacioneve dhe data bazave përkatëse të IRK-ve në platformën Open Source; Sistemi elektronik për menaxhimin e pasurisë shtetërore e- Pasuria; Sistemi i Intranetit të Komunave (SIK); Sistemit për Menaxhimin dhe Arkivimin Elektronik të Dokumenteve – SMAED; Sistemi elektronik i kartelave identifikuese; Sistemi i menaxhimit të vijueshmërisë në punë (SMVP).

Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike, në zbatim të vendimeve të Këshillit, ka përgatitur raportin për plotësim/ndryshim të listës së ekspertëve i miratuar sipas Vendimit me Nr. 09/216 të datës 14.08.2024 nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ashtu që në listën e ekspertëve lidhur me Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit janë përfshirë edhe pozita e ankuses Zyrtar i TI-së për Përkrahje klasa e pagës B7.

Ankuesja përmes Zv. të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Informacionit më datë 22.11.2024 i janë drejtuar Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme për kompensimin retroaktive të diferencës së pagës sipas listës së ekspertëve, por që nuk kanë pranuar përgjigje.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se kompensimi i pagës sipas kësaj kategorie bëhet në mënyrë retroaktive nga muaji shkurt 2023 kur ka hyrë në fuqi Ligji 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, duke kërkuar kompensimin për periudhën nga muaji shkurt 2023 deri më datë 14.08.2024.

Kolegji i Këshillit në kuptim të pretendimeve ankimore të ankuesit, i'u referua Ligjit 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, me theks të veçantë:

Nenit 1: Qëllimi i këtij ligji është që të krijojë një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik që përfshin parimet dhe rregullat për përcaktim të pagës në sektorin publik si dhe të krijojë një sistem të pagave dhe shpërblimeve, transparent dhe të menaxhueshëm ku elementi kryesor është paga bazë. cilin 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik”

Nenit 3 nënpikat 1.6, 1.7 dhe 1.9 ku përcaktohet së: 1.6. klasa e pagës - nënkupton nivelin e pozicionimit në hierarkinë e përgjithshme të funksioneve në shkallën e pagës e që i korrespondon koeficienti i caktuar dhe që përbëhet nga një grup funksionesh, pozitash apo gradash me nivel të njëjtë apo pothuajse të njëjtë kompleksiteti dhe që përfitojnë të njëjtën pagë bazë; 1.7. koeficienti i pagës apo koeficienti – nënkupton shprehjen numerike që korrespondon me klasën dhe grupin e pagës. Bazuar në këtë koeficient, llogaritet paga bazë për çdo pozicion...1. 9. paga bazë – nënkupton elementin kryesor fiks të kundërvlerës monetare mujore që i përgjigjet nivelit të kompleksitetit të funksionit, pozitës apo gradës dhe nivelit të kualifikimit të kërkuar për atë funksion, pozitë apo gradë, në përputhje me shtojcat e këtij ligji...” si dhe,

Nenit 14, paragrafi 3: Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik.

Kolegji i Këshillit, për vendosje të drejtë lidhur me këtë çështje administrative, mori parasysh edhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.11/2023 për Ekspertët, ku me nenin 6 ku përcaktohet se: 1. Qeveria e Kosovës më së largu pesë (5) ditë pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje emëron komisionin për vlerësimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike në këtë përbërje: 1.1. përfaqësues nga ministria përgjegjëse për administratë publike; 1.2. përfaqësues nga ministria e financave; 1.3. përfaqësues nga zyra e kryeministrit. 2. Institucionet publike që vlerësojnë se posedojnë, menaxhojnë ose koordinojnë sisteme shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike, duhet të dërgojnë kërkesat në Komision më së largu dhjetë (10) ditë pas themelimit të komisionit sipas paragrafit 1 të këtij neni. 3. Komisioni për vlerësimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike pranon kërkesat e dërguara nga institucionet dhe bënë vlerësimin tyre. 4. Komisioni në afat prej pesë (5) ditësh nga përfundimi i afatit sipas paragrafit 2 të këtij neni i dërgon Qeverisë për aprovim Listën e Ekspertëve të kategorizuar në shtojcën 14.4 të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik. 5. Klasat e pozitave si në paragrafin 4 të këtij neni, ju dedikohen mbajtësve të pozitave drejtuese të njësive organizative të fushës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, duke filluar nga drejtues të departamenteve, drejtorive, divizioneve, sektorëve apo njësive varësisht nga organizimi institucional në nivel të ndryshëm të Ministrive, Agjencive apo institucioneve të tjera të pavarura, koordinatore qendrore të procesit të digjitalizimit, deri në nivel të ekspertëve profesional që administrojnë, zhvillojnë ose mbështesin sisteme shtetërore me rëndësi strategjike. 6. Lista e ekspertëve sipas paragrafit 4 të këtij

neni duhet të përmbajë minimalisht të dhënat si në vijim: 6.1. sistemet shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike; 6.2. institucionet që posedojnë, menaxhojnë e koordinojnë sisteme shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike; 6.3. llojet dhe klasat e pozitive të përcaktuara brenda secilit institucion që posedon, menaxhon ose koordinon sisteme shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike.

Andaj, referuar kuadrit ligjor si me lartë, dhe meqenëse pozita e ankueses është përfshirë në listën e ekspertëve, atëherë, në vlerësimin e Kolegjit, pretendimet e ankueses për kompensim të diferencës së pagës së ekspertit sipas klasave të miratuar nga komisioni kompetent dhe Qeveria janë të bazuara për faktin se paga dhe koeficientet e pagës janë kategori ligjore të përcaktuara me Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i cili ka hyr në fuqi me datë 05.02.2023 dhe për rrjedhojë efektet juridike të këtij ligji lidhur me pagat rrjedhin nga data e hyrjes në fuqi, përjashtimisht, çështjeve përkatëse të përcaktuara ndryshe me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës AGJ 2316/24. Rrjedhimisht, nisur nga ky konstatim rezulton se kompensimi i ankuesve sipas shtojcës Nr. 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, gjegjësisht sipas kategorisë së klasës së pagave të miratuar nga Komisioni përkatës kompetent, duhet të aplikohet në mënyrë retroaktive nga data e hyrjes në fuqi e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit sjell në vëmendje edhe faktin relevant së Ministra e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Financave, më datë 31.03.2023, ka përcjell opinion të të gjitha institucionet publike lidhur me efektet e ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, me c ‘rast sipas pikës 4 të opinionit sqarohet se: Punonjës të cilëve vet shtojca përkatëse e Ligjit, u është përcaktuar klasifikimi i posaçëm, p.sh: ekspertë sipas shtojcës së posaçme, specialistët, inspektorët, punonjësit në arsim, shëndetësi, art, kulture e trashëgimi kulturore apo një fushë tjetër ?(vijon korrigjimi edhe në ditët dhe javët në vazhdim- pagat u barazohen retroaktivisht nga momenti i hyrjes në fuqi të Ligjit).

Andaj, theksuar si me lart Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, rrjedhimisht aprovoj ankesën si të bazuar dhe detyroj Sekretaren e Përgjithshme dhe Udhëheqësin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme Personelit, që të bëjnë kompensimin e diferencës së pagës për ankuesen nga muaji shkurt 2023 deri në muajin gusht 2024, bazuar në koeficientin e përcaktuar sipas raportit të Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet me Rëndësi Strategjike dhe të miratuar me vendimin e Qeverisë së Kosovës.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër: A.nr.208/2025

Ylber Fetahaj

Procesmbajtës

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses SH.SH;
- Organit të punësimit: Sekretares së Përgjithshme dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe;
- Arkivit të KPMSHCK -së.